



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2511 Prot.

Tiranë, më 7.02 2017

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Të gjithë Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë

Duke marrë shkas nga problematikat që autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë kanë ngritur mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") dhe Komisioni i Prokurimit Publik (në vijim "KPP"), ka rishikuar rekomandimin e përbashkët të datës 01.04.2015, me objekt "Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike".

Sjellim në vëmendjen tuaj se, rekomandimi i APP dhe KPP datë 01.04.2015 "Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike", **është shfuqizuar nga rekomandimi i datës 06.02.2017, i cili do t'i shtrijë efektet e tij për të gjitha procedurat e prokurimit që do të shpallen pas datës 13.02.2017.**

Këtë rekomandim do ta gjeni të publikuar në faqen tonë të web site.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti

